REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1127/20
Datë/Datum. 06.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTITT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i ekspertit Shqyrtues dhe nënshkrimi *Daut Retkoceri*	*Data e autorizimit të Ekspertit* *25.12. 2020*	*Data e dorëzimit të raportit* *06.01.2021*	Nr. i lëndës: 1127/20

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.12.2020, OE "ErPOWER" SH.P.K–Viti ka parashtruar ankesë me nr. :1127/20 , lidhur me aktivitetin e prokurimit: NDËRTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE Të OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE . me nr. të prokurimit: 62500-20-4721-5-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE , kundër B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES e publikuara përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net me datën 01.10. 2020,
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Punë,
Vlera e parashikuar e kontratës: 49 000,00 €

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETËNDIMET ANKIMORE "ErPower" SH.P.K–Viti

Dispozitat e shkelura dhe pikat e ankesës.

Përmes e-prokurimit me date 26.08.2020 është publikuar njoftimi per kontratë. Me date 09.09.2020 në orën 14:30h është bërë hapja e ofertave dhe ne ofertim kanë marrë pjesë katër (4) OE. Me datën 02.10.2020 shpallet VENDIMI i AK-se per dhënie te kontratës dhe marrim letër standarde për tenderuesin e Pasuksesshëm
Me date 08.10.2020 behet PEZULLIMI i AP duke u bazua ne ankesën e OE ELECTRA GRAQANICE dhe te njëjtën dite prapë ngritët VENDIMI nga AK ku e Zen ne fuqi vendimin e vet dhe refuzohet ne shkallë te pare ankesa e OE ELETRA GRAQANICE.
Me date 02.12.2020 kërkohet nga OE zgjatja e validitetit te ofertave dhe sigurimi i tenderit.
Me date 11. I2.2020 ngitet përsëri VENDIMI nga AK dhe shpallet fitues i tenderit OE ELETRA GRAQANICE dhe ne marrim përsëri letër standarde per tenderuesin e Pasuksesshëm

Shpërblimi i këtij OE me kontrate nga ana e Komunës se Malishevës është i padrejtë per arsye se OE i shpallur fitues nga ana e AK-se nuk e ka VAZHDUAR VALIDITETIN E OFERTES NE DITE 60 siç ka kërkuar AK por vetëm e ka lëshuar një deklaratë pa date me te cilën ka deklaruar se e ka pranuar SHKRESEN E AK-së per zgjatje te validitetit te ofertave dhe se nuk e ka vazhdua validietin edhe per 60 dite duke u bazuar ne shkresën e AK-se Komuna e Malishevës

AK gjate zhvillimit te këtij aktiviteti te prokurimit konkretisht gjate procesit te RI vlerësimit te tenderëve ka bere shkelje te dispozitave te Ligjit Nr.04/L-042 per prokurim Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/"-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia ne trajtim
Neni 59,4 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
Neni 60.1.1 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Shkelja 1.
AK gjatë fazës së vlerësimit të tenderit ka bere shkelje të LPP ne nenet e cekura ne piken 7, duke mos vlerësuar drejtë kur ka konstatuar të shpallë fitues OE ELETRA GRAQANICE
AK e ka marre per baze një deklaratë pa date me te cilën OE ka deklaruar se e ka pranuar SHKRESEN E AK-së per zgjatje te validitetit te ofertave dhe se nuk e ka vazhdua validietin edhe per 60 dite duke mos e respektuar kërkesën e AK-se Komuna e Malishevës.

AK nuk e ka vlerësuar ofertën e përgjegjshme të ofruar nga ne si OE

Duke i pare shkeljet e LPP-se te Komunës se Malishevës ne kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-s që ankesën tonë ta pranoj si të bazuar dhe këtë procedurë tae kthej në rivlerësim në mënyrë që AK të ketë mundësi të eliminoj shkeljet e bëra.

KRITËRET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
1. Të paraqitën kontratat e punëve të ngjashme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (vetëm për pune te ngjashme) minimum tri kontrata.	a. Lista e kontratave - origjinal të natyrës se ngjashme (vetëm per pune te ngjashme) ne tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë te bashkangjitura me kopjet proceseve, raporteve te pranimeve , referenca apo te ngjashme, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) ose proceset e pranimeve nga OE privat, me kusht qe pagesat te janë kryer nëpërmes institucioneve bankare.
2.Të paraqitën pajisjet mjetet stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. Pajisje te domosdoshme minimum një kamion me vinç dhe një kamionet me platformë ngritëse	b. Lista e pajisjeve – për të gjitha kërkesat rreth pajisjeve të shënuara duhet të ofrohen dëshmitë (librezat e automjeteve valide qe kompania i ka ne pronësi (automjetet duhet te jene me regjistrim valid) ose te ketë kontrate mbi shfrytëzimin e tyre (qira).
3.Operatori Ekonomik të ketë një inxhinier të elektros ose master	Për inxhinierin e elektros ose master diploma e tij e noterizuar, CV-i e tij dhe kontrata e punës.
4.Autorizimi nga prodhuesi per panelet 24v, transformator, blinde metalike dhe panel të tensionit të ulet.	4.Autorizimi nga prodhuesi per panelet 24v, transformator, blinde metalike dhe panel të tensionit të ulet.
5.Katalogu per panelet 24v, transformator, blinde metalike dhe panel të tensionit të ulet.	5.Katalogu per panelet 24v, transformator, blinde metalike dhe panel të tensionit të ulet.
6.Të paraqitën pajisjet mjetet stabilimentet që janë dispozicionin tuaj për realizimin e projektit. Pajisje te domosdoshme Minimum një kamion me vinç dhe një kamionet me platform ngritëse Instrument 10kv per matje te izolimit te kabllove se bashku me certifikat te kalibrimit	b. Lista e paisjeve – për të gjitha kërkesat rreth pajisjeve të shënuara duhet të ofrohen dëshmitë (librezat e automjeteve valide qe kompania i ka ne pronësi (automjetet duhet te jene me regjistrim valid) ose te ketë kontrate mbi shfrytëzimin e tyre (qira).

Instrument për matje te togzimit se bashku me certifikatë te kalibrimit	

Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☒ Jo ☐ *Nëse kërkohet sigurimi i tenderit:* Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.
Periudha vlefshmërisë së tenderit	21.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: **60** ditë, ose muaj, ose deri në datën .

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Raporti i vlerësimit për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore

Komisioni mendon dhe rekomandon dhentën e kontratës OE „ELECTRA" SHPK Prishtinë per arsye se ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët në krahasim me ofertat tjera përgjegjëse.

INFORMACIONET SHTËSË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPËRTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Jo

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Operatori ekonomik ankues "ErPower" SH.P.K–Viti sipas nenit 4.1.26 të LPP-së janë palë me interes sepse Komisioni për vlerësimin e ofertave gjatë vlerësimit , ofertën e tij e ka shpallë të pasuksesshëm

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTËT E NGJASHME

Psh. NR. 786/20 dt.16.11. 2020

I. **APROVOHET** , si e bazuara ankesa e operatorit ekonomik "ELECTRA"SH.P.K. – SUHODLL lidhur me aktivitetin e prokurimit: ndërtimi i trafostacionit për kyçje të objekteve publike dy qendrat e banimit social dhe dy çerdhet publike . me nr. të prokurimit: 62500-20-4721-5-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Malisheve

II. **ANULOHET**, njoftimi per dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit: ndërtimi i trafostacionit për kyçje të objekteve publike dy qendrat e banimit social dhe dy çerdhet publike . me nr. të prokurimit: 62500-20-4721-5-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Malishevë, lënda kthehet ne Rivlerësim

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ErPOWER" SH.P.K–Viti

"ErPower" SH.P.K–Viti – ankues

PRETENDIMI

Lidhur me pretendimin e **"ErPower" SH.P.K** – ankues se AK gjatë fazës së vlerësimit të tenderit ka bere shkelje të LPP ne nenet e cekura ne piken 7, duke mos vlerësuar drejtë kur ka konstatuar të shpallë fitues OE "ELECTRA" GRAQANICE

AK e ka marre per baze një deklaratë pa date me te cilën OE ka deklaruar se e ka pranuar SHKRESEN E AK-së per zgjatje te validitetit te ofertave dhe se nuk e ka vazhdua validietin edhe per 60 dite duke mos e respektuar kërkesën e AK-se Komuna e Malishevës.

AK nuk e ka vlerësuar ofertën e përgjegjshme të ofruar nga ne si OE

Duke i pare shkeljet e LPP-se te Komunës se Malishevës ne kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-s që ankesën tonë ta e pranoj si të bazuar dhe këtë procedurë ta e kthej në rivlerësim në mënyrë që AK të ketë mundësi të i eliminoja shkeljet e bëra

PËRGJIGJEJE NË PRETENDIMIN

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues "ErPower" SH.P.K duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues pjesërisht qëndron sepse pas kerkese nga Ak-ja per vazhdimin e validitetit nga operatorret ekonomik pjesëmarrës ne ofert , Operatori ekonomik "ELECTRA" SH.P.K me daten 07.12.2020 ka dorëzuar Deklaratën:

ELE TRA

Nga : Electra SHPK – Magjistralja Prishtinë – Lipjan , Suhodoll , 10500 Graçaicë

Për : Departamenti I Prokurimit

Kuvendi Komunal Malishevë

DEKLARATË

Me anë të kësaj deklarate konfirmojmë pranimin per zgjatje të validitetit të oferatve për tenderin **NDËRTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE TË OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE , nr.i prokurimit 62500-20-4731-5-2-1 , nr I brendshëm I prokurimit 62500-20-107-521**

Me respekt ,

Valon Gashi

SH.P.K. ELECTRA GRAÇANICË

Siç shihet nga Deklarata me larte OE pranon vazhdimin e validitetit te ofertës mirëpo nuk përcakton numrin e ditëve qe do ta vazhdoj validitetin e ofertës.

Eksperti shqyrtues mendon se ky është një gabim minor pasi qe AK me kërkesën e saj te datës 02.12.2020 kërkon nga Operatoret Ekonomik qe te bëjnë **KONFIRMIMI** për zgjatjen e validitetit te ofertues te cilën OE "ELECTRA" SH.P.K e ka bere sipas kërkesë si dhe vazhdimin e sigurimit te tenderit te cilën e ka bere ne Kompaninë e Sigurimit "ELSIG" me numër te Polices nr. 89388 data e lëshimit 03.12.2020 ne kohe zgjatej prej 90 dite kalendarike

Me poshtë po japin kërkesën AK-se për Zgjatjen e validitetit dhe te vazhdimit te sigurimit te ofertës.

Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës

Drejtoria për Administratë dhe Personel
Zyra e Prokurimit

Të nderuar,

DATË	02.12.2020
REFERENC-E	
PËR/ZA/TO	Operatoret Ekonomik
NGA/OD/FROM	**Nuhi Shalaj** Zyrtar i Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kërkesë për zgjatje e validitetit të ofertave dhe sigurimit te tenderit në bazë te Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik

Ju njoftoj se për arsye objektive **NDËRTIMI I TRAFOSTACIONIT PËR KYQJE TË OBJEKTEVE PUBLIKE DY QENDRAT E BANIMIT SOCIAL DHE DY ÇERDHET PUBLIKE Nr identifikues 62500.20.107.521.** nuk është finalizuar.

Në mënyre që të vazhdohen procedurat e prokurimit kërkojm nga ana e juaj duke u bazuar në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik Neni 31 Validiteti i Tenderit paragrafi 4 **qe te zgjatni validitetin e ofertave për një periudhe prej "60" ditësh.**

Ju duhet të bëni edhe vazhdimin e sigurimit të tenderit në vlerë prej 1,000.00€ edhe per 90 ditë.

Konfirmimin për zgjatje te validitetit te ofertave dhe vazhdimimin e sigurimit të tenderit duhet të i konfirmoni me se largu 07.12.2020 ne ora 14:00h **E-Prokurim tek aktiviteti i prokurimit i cekur më lartë.**

Nëse zgjatja e validitetit të ofertës dhe vazhdimi i sigurimit të tenderit nuk konfirmohet brenda afatit kohor të lartë shënuar, oferta juaj do të refuzohet si e papërgjegjëshme.

PS:Kjo vlenë për të gjithë Operatorët Ekonomik.

Me Respekt!
Menaxheri i Prokurimit

Nuhi Shalaj

Siç shihet ne baze te kërkese është kërkuar zgjatja e validitetit te ofertës për një periudhe prej 60 ditësh dhe sipas kësaj kërkesës është kërkuar vetëm konfirmimi për zgjatjen e validitetit te ofertave.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues nuk qëndron.

MENDIMI I EKSPERTITT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa operatorit ekonomik ankues. **"ErPower" SH.P.K** të merret si pjesërisht e bazuar. Dhe rekomandon që të mbetet ne fuqi vendimi i AK-se B58- NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Raporti i Ekspertizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues	– KUVENDI KOMUNAL MALISHEVË
Panelit Shqyrtues	– OSHP-së.
OE ankues	– "ErPOWER" SH.P.K–Viti